



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjeno / Prodato Received / Delivery	13.12.2021	viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSTOK	6059/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.921/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.921/2021 të datës 11.11.2021 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit /Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 13.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.921/2021 e datës 11.11.2021, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi nëpunës civil në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 11.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, lidhur me mos sistemimin e përhershëm në pozitën e punës sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit Nr.96/2016 të datës 04.03.2016.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 15.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datë 17.11.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritorë, ka administruar këto prova: Ankesën me numër A.nr.921/2021, të datës 11.11.2021,

drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 03.11.2021 të ankuesit drejtuar Zëvendësuesit të Sekretares së Përgjithshme të MPJD, Vendimin me numër ref.176/2021 të datës 01.10.2021, Vendimin me nr.232/2021 të datës 09.12.2020, Ndryshimin dhe plotësimin e Akt Emërimit me nr.96/2016 të datës 04.03.2016; Ndryshimin dhe plotësimin e Akt Emërimit me numër 096/2014 të datës 28.02.2014, Akt Emërimit të datës 18.10.2013, Akt Emërimit të datës 19.10.2012; Vendimin me numër 34/1 të datës 18.04.2014, Vendimin me nr.ref 377/2016 të datës 13/09/2016, Vendimin me nr. 338/2020 të datës 10.07.2020, vendimin me numër 82/2019 të datës 14.02.2019, Vendimin me nr.ref.176/2020 të datës 01/10/2020, Vendimin me nr.232/2020 të datës 09.12.2020, Vendimin me numër 82/2019 të datës 14.02.2019, Përgjigje në ankesë të datës 17.11.2021, me numër protokolli 5482/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit **është parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Ndryshim dhe Plotësim të Akt Emërimit Nr.-96/2016 të datës 04.03.2016, është emëruar në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Organizata Ekonomike Ndërkombëtare" në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme tani Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesi me Vendimin nr.338/2020 të datës 10.07.2020 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (me tej MPJD), është kthyer nga misioni diplomatik në gradën diplomatike Sekretar i Dytë në Ambasadën e Kosovës në Zagreb, ndërsa me Vendimin nr.ref.176/2020 të datës 01.10.2020 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD, ankuesi është sistemuar përkohësisht në pozitën e punës " Zyrtar i Lartë për të Drejtën Ndërkombëtare" në kuadër të Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate. Me pastaj, me Vendimin me numër ref.232/2020 të datës 09.12.2020, të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankuesi është transferuar përkohësisht nga pozita e punës së Zyrtarit të Lartë për të Drejtën Ndërkombëtare në pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Këshillin Evropian dhe Evropën Perëndimore në Departamentin për Evropë dhe BE.

Ankuesi i pakënaqur me sistemimin e pakohshëm sipas Vendimit me numër ref.232/2020 të datës 09.12.2020, me datë 11.11.2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me kërkesën për sistemimin e tij në pozitën të cilën ankuesi e ka sipas Akt Emërimit-Zyrtar i Lartë për Organizata Ekonomike Ndërkombëtare.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nën 24 paragrafi 3 të këtij Ligji, çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nën 127 paragrafi 1 përcakton se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.* Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke marrë parasysh se ankuesi Vendimin me numër ref.232/2020 të datës 09.12.2020 për transferimin e përkohshëm nga pozita e punës së Zyrtarit të Lartë për të Drejtën Ndërkombëtare në pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Këshillin Evropian dhe Evropën



Perëndimore, e ka marrë më datë 09.12.2020 ashtu siç pohon vet ankuesi në ankesën e tij, Kolegji konstaton se ankesa e datës 11.11.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që bazuar në rrethanat si me lartë dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente/ Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.Nr.921/2021

Rushit KAJTAZI

Proesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ -DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës,
- Arkivit të KPMSHCK-së